

HËNA PASHO

PROBLEME GJUHËSORE TË TERMINOLOGJISË NË REVISTËN “STUDIME FILOLOGJIKE”

I. Revista jonë, bashkudhëtarja jonë në rrugën e vështirë të formimit si studiues të gjuhës sonë na dha mundësinë që, në artikujt e botuar, të gjenim përgjigje për probleme për të cilat interesoheshim, të gjenim zgjidhje për probleme të ndërlikuara të teorisë së gjuhësisë, të këmbenim mendime për probleme aktuale të gjuhës; na siguroi informacionin e duhur për probleme e tema të reja që kërkonin studim të mëtejshëm si edhe për jetën shkencore në fushën e filologjisë.

Studimi i aspekteve të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme synonin në njohjen e dukurive që në fillimet e tyre, gjatë zhvillimit të tyre historik deri në gjendjen bashkëkohore.

Gjerësia e tematikës së punimeve, orientimi profesional i trajtimit të problemeve bënë që kjo revistë, në nivelin më të mirë shkencor, të bëhej pikë referimi edhe për organe të tjera botuese shkencore. E pasuruar ndjeshëm letërsinë filologjike.

II. Pjesë e kësaj letërsie filologjike janë edhe punimet për terminologjinë. Terminologjia është një fushë studimi relativisht e re në krahasim me fusha të tjera, jo vetëm tek ne.

Është fushë studimi paksa e veçantë, rëndësinë e së cilës, rolin e ndjeshëm të saj e kanë përmbledhur në një fjali të thjeshtë: “*Një shkencë e saktë është një terminologji e saktë*”. Pikërisht, nga gjendja e një terminologjie të papërpunuar në fushat e ndryshme të shkencës e të teknikës u ndje si nevojë e ngutshme puna për normalizimin e saj që filloi menjëherë, pa studime paraprake, por mbështetur në atë pak përvojë nga tradita me fjalorët dygjuhësh dhe në përvojën e vendeve të tjera.

Nën drejtimin e ish Institutit të gjuhësisë dhe të Letërsisë, nëpërmjet sektorit të terminologjisë, përpunimi i terminologjisë dhe kodifikimi i saj në fjalorë terminologjikë (shqip - gjuhë të huaja) mori përparësi. Pasqyrë e ecurisë së punës me terminologjinë është edhe revista “Studime filologjike”.

Nga recensionet për fjalorët e botuar, në fillim, bëhet pjesë e punimeve të veçanta gjuhësore që dilnin gjatë punës për hartimin e fjalorëve, studime më të thelluara për probleme teorike që shkaktonin diskutime, aspekte të ndryshme të zhvillimit të terminologjisë dhe probleme që kërkonin zgjidhje.

Por, gjithnjë, parësor, diku drejtpërdrejt si objekt studimi e, diku, për probleme të veçanta, ka qenë bashkëveprimi dhe ndërveprimi i gjuhës me

terminologjinë në të gjitha rrafshet. Dhe, nga ky nivel punimesh, si rezultat i përvojës së fituar, problemet gjuhësore të terminologjisë trajtohen edhe në nivel monografish, pjesë të të cilave botohen edhe në revistën “Studime filologjike”.

III. Vërtet puna me terminologjinë filloi me hartimin e fjalorëve terminologjikë, me atë që quhet gjuhësi e zbatuar, por ishte i domosdoshëm trajtimi i problemeve gjuhësore që dilnin gjatë punës për hartimin e fjalorëve terminologjikë.

1) Natyrshëm, parësor ka qenë gjithnjë *problemi i burimeve të formimit të termave*; sa dhe si është shfrytëzuar leksiku i gjuhës me shtresimet e veta dhe mënyrat e njetet e fjalëformimit; në fillim trajtohet si pjesë e një teme më të gjerë e, më pastaj, si objekt i drejtpërdrejtë analize në punime të ndryshme¹ si: “Mbi leksikon politiko-shoqëror të shqipes dhe zhvillimi i tij pas Çlirimit”; “Terminologjia ushtarake pas Çlirimit”; “Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas Çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe”; “Zhvillime kuptimore në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe pas Çlirimit”, “Vëzhgime mbi leksikon terminologjik në FGJSSH”.

Punimet e renditura kanë të njëjtë analizën e burimeve të shfrytëzuara për formimin e termave sipas kushteve në periudha të ndryshme që çuan në zhvillimin e terminologjisë së fushave që analizohen diku më gjerë, për sa i përket shtrirjes në kohë, diku më ngushtë, diku në një aspekt, p.sh. në aspektin e fjalëformimit ose në aspektin leksiko-semantik, diku në më shumë aspekte, po përmbledhtas.

Por, megjithatë, vihet në dukje që ndryshimet sasiore në leksik e fjalëformim, në strukturën gramatikore dhe në përmbajtjen kuptimore kanë kaluar ndryshime cilësore që vihen re: a) në ndryshimin e vëllimit kuptimor, b) në lëvizjen e semantikës së termit gjatë përdorimit, c) në rigrupimin e kuptimeve në strukturën kuptimore të termit dhe ç) në formimin e kuptimeve abstrakte.

Në dy punimet në të cilat është zgjeruar analiza edhe me problemin e pasqyrimin të terminologjisë në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe: FGJSH (1954) dhe FGJSSH (1980), njëri për terminologjinë e një fushe e tjetri për një grup shkronjash në FGJSSH, vënë në dukje vendin që zë terminologjia në të dy

¹ M. Samara, *Mbi leksikon politiko-shoqëror të shqipes dhe zhvillimi i tij pas Çlirimit*, SF, 1970/1; F. Leka, *Aspekte të zhvillimit të terminologjisë tekniko-shkencore pas Çlirimit*, SF, 1970/1; H. Çipuri, *Terminologjia ushtarake pas Çlirimit*, SF, 1984/4; H. Pasho, *Zhvillimi i terminologjisë së ekonomisë pas Çlirimit dhe pasqyrimi i saj në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*, SF, 1984/1, *Zhvillime kuptimore në terminologjinë e ekonomisë në gjuhën shqipe pas Çlirimit*, SF, 1988/2; Th. Feka, *Vëzhgime mbi leksikon terminologjik në FGJSSH*, SF, 1986/2.

fjalorët dhe veçojnë pasqyrimin e gjerë të saj në FGJSSH, gjë që tregon për peshën specifike të shtuar të terminologjisë në leksikon e gjuhës shqipe.

2) Problem tjetër është ai që ka të bëjë me një *kategori termash që kanë shkaktuar diskutime në rrafshin konceptor*, termat-togfjalësha të cilët, në fjalorët terminologjikë, përbëjnë numrin më të madh të termave. Për këtë kategori termash, analizuar nga këndvështrime të ndryshme ka gjithnjë diskutime.

Në punimin “Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme”² autori shqyrton togfjalëshat e thjeshtë për nga këndvështrimi i *qëndrueshmërisë së lidhjeve ndërmjet përbërësve* për të cilën ka patur mendime të ndryshme. Ai e qartëson këtë problem duke krahasuar togfjalëshin terminologjik me togfjalëshin në gjuhën e përgjithshme, me togfjalëshin frazeologjik dhe me togfjalëshin e lirë; ka vënë në dukje të përbashkëtat dhe veçoritë dalluese për nga funksioni, nga ndërtimi semantiko-strukturor dhe, natyrisht, për nga qëndrueshmëria e lidhjeve ndërmjet përbërësve. E analizuar kështu del që është njësi emërtuese që, sidomos, në terminologji është e domosdoshme, sepse plotëson një nevojë për emërtime që i përgjigjen shkallës së zhvillimit të mendimit shkencor.

Kurse në punimin “Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë”³ autorja ka objekt studimi një tip togfjalëshi, togfjalëshin emëror, por *për nga vëllimi, d.m.th. për nga sasia maksimale e fjalëve shënuese si përbërës të tij, numri i të cilëve arrin deri në gjashtë*.

E vetëdijshme për atë që një njësi e tillë bie ndesh me një nga karakteristikat e termit sipas së cilës termi duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë i volitshëm në përdorim, autorja mendon që praninë e këtij tipi togfjalëshi e kushtëzon zgjerimi i përmbajtjes së koncepteve e i lidhjeve ndërmjet tyre si dhe kërkesa për një saktësi më të madhe të emërtimit të nuancave konceptore, aq të domosdoshme për terminologjinë.

E bën të diskutueshëm këtë togfjalësh numri i përbërësve, por autorja parashtron argumentet pse i trajton si terma:

a) Pavarësisht nga numri i përbërësve, ata janë si togfjalëshat e tjerë, togfjalësha dygjymtyrësh.

b) I bën të diskutueshëm, gjithnjë si pasojë e numrit të përbërësve, shkalla e terminologjizimit që është më e vogël në krahasim me togfjalëshat e thjeshtë.

² A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, SF, 1982/4.

³ H. Pasho, *Togfjalëshat e zgjeruar emërorë në terminologjinë e ekonomisë*, SF, 1985/4.

c) Struktura që i bën të diskutueshëm ndryshon në gjuhë të ndryshme, p.sh.: në shqip: *eksportim i lirë nga taksat doganore*, në frëngjisht: *exportation en franchise*.

ç) Pavarësisht nga struktura e gjerë, ata përfaqësojnë grupe të lidhura ngushtë sintaktikisht dhe semantikisht.

Me këto argumente autorja mendon se këta togfjalësha do të vazhdojnë të jenë të pranishëm në terminologji, ndoshta jo me atë shtrirje të togfjalëshave që quhen të pranueshëm, togfjalëshat me nga dy deri katër përbërës.

3) *Problem i trajtuar, diku më gjerë e diku në ndonjë aspekt, është edhe prania e dukurive kuptimore në terminologji.*

Në punimin “Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimësisë, sinonimisë dhe antonimisë në terminologjinë e ekonomisë”⁴ autorja duke analizuar shkaqet e shfaqjes së shumëkuptimësisë, sinonimisë dhe antonimisë, faktorët që ndikojnë dhe format si shfaqen këto dukuri në këtë terminologji, arrin në përfundimin se shumëkuptimësia dhe sinonimia, ndryshe nga prania e tyre në gjuhë ku tregojnë pasurinë e saj, në *terminologji sjellin pështjellime*, sepse *prania e shumëkuptimësisë* thyen rregullën sipas së cilës një fjalë duhet të emërtojë vetëm një koncept, kurse *prania e sinonimisë* thyen rregullën sipas së cilës një koncept duhet të emërtohet vetëm nga një fjalë.

Në analizën e antonimisë, si dukuri pozitive edhe për terminologjinë, vihet në dukje se ç’kanë të përbashkët dhe ç’kanë të veçantë çiftet antonimike në gjuhë. Si përfundim, antonimia e karakterizon pozitivisht edhe terminologjinë, sepse çiftet antonimike e pasurojnë atë dhe forcojnë karakterin sistemor të saj, kurse termat e shumëkuptimshëm dhe sinonimë sjellin pështjellime, prandaj në punën për hartimin e fjalorëve terminologjikë synohet që të shmangen në shkallën më të mundshme.

Edhe në punimin “Grupet paradigmatiche të fjalëve dhe të termave në gjuhën shqipe”⁵ autori, duke vënë përballë këto dy kategori sipas veçorive të tyre, nxjerr vlerat dhe problemet sidomos për terminologjinë, sepse kanë të bëjnë me shumëkuptimësinë dhe sinoniminë që, për terminologjinë, janë dukuri negative.

4. Problem i mprehtë që vazhdon të jetë shqetësues, edhe për gjuhën, është përdorimi pa kriter i fjalëve të huaja. Dihet që terminologjia është quajtur *porta e hapur nga hyjnë fjalët e huaja në gjuhë*, prandaj mënjanimi, në shkallën më të mundshme i fjalëve-terma të huaj të panevojshëm ka qenë jo vetëm një nga detyrat kryesore në punën për përpunimin e terminologjisë, por

⁴ H. Pasho, *Vështrim mbi disa shfaqje të shumëkuptimësisë, sinonimisë dhe antonimisë në terminologjinë e ekonomisë*, SF, 1986/3.

⁵ A. Duro, *Grupet paradigmatiche të fjalëve dhe të termave në gjuhën shqipe*, SF, 1989/4.

edhe problem i trajtuar në punime të ndryshme, pjesërisht në aspekte të ndryshme, ose i plotë si objekt i veçantë analize.

Ka një varg punimesh⁶ në të cilat është sjellë një pasuri e madhe e leksikut të shqipes nga tradita si: “Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e pahuazuara”; “Leksiku detar i shqipes dhe etnogjeneza e popullit tonë”; “Kontributi i Xhuvanit në terminologjinë shqipe”; “Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore të gjuhës shqipe”; “Leksiku terminologjik në veprën mësimore të Naim Frashërit”, “Leksiku dialektor në terminologjinë tekniko-shkencore”, “Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri” të P. Tases”.

Kjo tërësi fjalësh është me vlerë të madhe, si burim i brendshëm për formimin e terminologjisë së fushave të ndryshme dhe jo vetëm si leksik por, shpesh, edhe si gjedhe për formim të fjalëve-terma të rinj që janë përdorur edhe për të zëvendësuar termat e huaj të panevojshëm. Kështu në punimin “Probleme të shqipërimit të terminologjisë në kohën tonë”⁷ autori vë në dukje veçoritë që dallojnë shqipërimin e fjalës së gjuhës së përgjithshme nga shqipërimi i termit; faktorët që ndikojnë si brenda dhe jashtë terminologjisë, faktorë terminologjikë dhe ndërgjuhësorë, faktorë historikë etj. Analizuar në këtë rrafsh, vë në dukje vështirësinë dhe kujdesin që duhet treguar në punën për shqipërimin e termave.

Në dy punime të tjera: “Huazime dhe ndërkombëtarizma në terminologjinë tonë tekniko-shkencore”⁸ dhe “Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe”⁹ janë bërë objekt analize dy grupe fjalë-terma: termat me shtrirje ndërkombëtare dhe termat që huazohen nga gjuhë të ndryshme, por që nuk janë me shtrirje ndërkombëtare. Autori i punimit të parë ka objekt analize vendin që zënë termat e huazuar në gjuhë në bazë kriteresh shkencore, si në rrafshin teorik edhe në rrafshin praktik mbi bazë të terminologjisë së tri fushave të së drejtës, të së drejtës ndërkombëtare dhe të tregtisë së jashtme të përpunuar dhe të kodifikuar në fjalorët përkatës.

⁶ L. Dodbiba, *Leksiku i sotëm detar i shqipes dhe elementet e pahuazuara*, SF, 1967/1, *Leksiku detar i shqipes dhe etnogjeneza e popullit tonë*, SF, 1972/4, *Kontributi i Xhuvanit në terminologjinë shqipe*, SF, 1980/1; E. Çabej, *Elemente vendëse në terminologjinë gjeografike malore të gjuhës shqipe*, SF, 1979/3; H. Pasho, *Leksiku terminologjik në veprën mësimore të Naim Frashërit*, SF, 1991/2, *Leksiku dialektor në terminologjinë tekniko-shkencore*, SF, 1998/1-2, *Vështrim mbi leksikun krahinor të “Fjalorthit të ri” të P. Tases*, SF, 2001/3-4.

⁷ A. Duro, *Probleme të shqipërimit të terminologjisë në kohën tonë*, SF, 1995/1-4.

⁸ F. Leka, *Huazime dhe ndërkombëtarizma në terminologjinë tonë tekniko-shkencore*, SF, 1985/2.

⁹ H. Pasho, *Fjalët e huaja në gjuhën letrare shqipe*, SF, 1999/1-2.

Në punimin e parë shqyrtohen *ndërkombëtarizmat*, më gjerë ato nga gjuhët klasike dhe nënvizohet se ato kanë hyrë në gjuhën tonë nëpërmjet gjuhëve të tjera, disa me kuptimin që kanë pasur në gjuhën e prejardhjes, disa me përmbajtje të ndryshuar.

Termet e huazuar nga gjuhë të ndryshme, përfshi edhe terma me shtrirje ndërkombëtare, konkretisht nga anglishtja, italishtja dhe turqishtja analizohen: për nga vendi që zënë në gjuhë dhe pasqyrimi i tyre në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (1980) Ë ndërkombëtarizmat janë pasqyruar më gjerë, termat e huazuar nga italishtja janë më të shumtë në numër sesa fjalët jotërma, kurse termat nga anglishtja janë të rrallë e ato nga turqishtja të paktë; për nga zhvillimi origjinal i semantikës së huazimeve brenda shqipes dhe përvetësimi i tyre nga sistemi morfologjik e fjalëformues; për nga shkalla e shqipërimit duke përfshirë këtu edhe ndërkombëtarizmat megjithëse, sipas kritereve, ata mbeten në përgjithësi të huaj.

b) Në punimin e dytë autorja thekson se puna e gjerë dhe e ngulët që u bë për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës e kishte bazën te puna me terminologjinë, *te zgjidhja e problemit të huazimit*, për të cilin në *rrafshin teorik* u caktuan kritere që, në rrafshin praktik, lehtësonin punën për përzgjedhjen e fjalëve të huaja që do të përfshiheshin në fjalorët terminologjikë.

Brenda këtyre kritereve, mbi një bazë të gjerë materiali, siç është terminologjia e tri fushave, që u përmendën më lart, autorja shqyrton: ç'kategori fjalë-termash janë quajtur të domosdoshme për t'u përfshirë në këta fjalorë; ç'vlerë kanë këto fjalë: ç'rol kanë luajtur, ç'shtrirje kanë në gjuhën letrare dhe në ç'shcallë janë përvetësuar prej saj. Si përfundim: ndër fjalët e huaja, në terminologjinë e tri fushave, vend të rëndësishëm zënë ndërkombëtarizmat, të cilët kanë ndihmuar në formimin e terminologjisë së këtyre fushave dhe, si të domosdoshëm, janë përvetësuar nga gjuha letrare. Termet e huaj jo me shtrirje ndërkombëtare kanë plotësuar një nevojë dhe, me kohë, me krijimin e mundësive për të zëvendësuar me fjalë shqipe, dolën nga përdorimi për një kohë të gjatë, por me shkujdesjen që po tregohet ndaj gjuhës, u bë një kohë jo e shkurtër që në ditët e sotme janë kthyer përsëri në përdorim, duke krijuar kështu një gjendje shqetësuese.

Këto ishin problemet kryesore, ndërmjet problemeve gjuhësore të terminologjisë, të analizuar në punime që janë botuar në revistën "Studime filologjike" e të trajtuar brenda caqeve të një kumtese.

SUMMARY

LINGUISTIC PROBLEMS OF TERMINOLOGY IN “STUDIME FILOLOGJIKE” (PHILOLOGICAL STUDIES) JOURNAL

The author in this paper gives a brief view of “Studime filologjike” (Philological Studies) journal. The journal reached the best scientific level and became a reference point for other organs of scientific publishing because it covered a wide range of issues and had a professional orientation of examined problems. The journal has significantly enriched the philological literature, part of which are the studies on terminology.

The author focuses on the main problems of linguistic terminology in the works published in this magazine. Specifically:

a) The problem of the source of the terms formation: how much and in what way is the lexicon of the language used with its stratification, its ways and its means of word formation.

b) Another problem is the one that deals with a category of terms which have been discussed on the conceptual level, the terms made up by groups of words. These terms constitute the largest number of terms in the terminological dictionaries.

c) A problem that was tackled in a deep way or just in one aspect is the presence of semantic phenomena in terminology, how do they work and how they characterize the terminology in comparison to language.

ç) An acute problem that continues to be a concern for the language is the use of foreign words and the attitude towards them. The author specifies that the works that have been focused on the analysis of this problem in different aspects have pointed out that the problem of the attitude towards borrowings has been solved during the work on the normalization of the terminology: scientific criteria were set on a theoretical level which in practical terms facilitate the work for the selection of foreign words to be included in the terminological dictionaries.

The analysis of all these problems that we presented briefly has been based on a linguistic factual material in all the articles that were focused on these issues.

